




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



---

**Njësia e Burimeve Njerëzore**

---

Njësia e Burimeve Njerëzore

Nr. 02-016-113194

Datë: 27.09.2021

Njësia e Burimeve Njerëzore pas hartimit të raportit të shkurtë të kandidatëve pjesëmarrës në shpalljen e publikuar me nr.02/016/101772 të datës 02.09.2021 për plotësimin e pozitave të lira punuese me datë 27.09.2021 harton;

**NJOFTIM  
PËR  
LISTËN E SHKURTËR**

E kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për ngritje (avancim) në detyrë dhe kërkesat e veçanta sipas pozitave ku kanë aplikuar e që ftohen në test me shkrim:

**Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari**

**Udhëheqës i sektorit të pylltarisë**


**1. Kujtim Shahiqi**

Për datën e mbajtjes së testit me shkrim do të njoftoheni me kohë.



**Njësia për Burime Njerëzore**  
Udhëheqësi i personelit

**Besim Azizi**



## Njësia për Burime Njerëzore

Nr.02-016-113199

Datë: 27.09.2021

Njësia për Burime Njerëzore, në procesin e verifikimit paraprak të plotësimit të kushteve për ngritje (avancim) në detyrë dhe kërkesave të veçanta për pozitën e lirë punuese; Udhëheqës i sektorit të pylltarisë në kuadër të DBP sipas shpalljes së publikuar për ngritje (avancim) në detyrë me nr.02-016-101772 të datës 02.09.2021 në mbështetje të nenit 45 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me datë 27.09.2021 merr:

### V E N D I M

**Refuzohet** aplikacioni i aplikantit Malazog Hoxha dhe i njëjti nuk ka të drejtë të vazhdoj më tej konkurrimin për ngritje (avancim) në detyrë për shkak të mos plotësimit të kushteve të veçanta për pozitën e lirë punuese; Udhëheqës i sektorit të pylltarisë në kuadër të DBP.

### Arsyetim

Malazog Hoxha, me datë 20.09.2021 ka konkurruar sipas shpalljes së konkurrimit të publikuar me datë 02.09.2021 për ngritje (avancim) në detyrë për plotësimin e pozitës së lirë punuese; Udhëheqës i sektorit të pylltarisë në kuadër të DBP.

Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit Njësia për Burime Njerëzore me datë 27.09.2021 ka bërë verifikimin paraprak të dokumentacionit nëse kandidati i plotëson kushtet për ngritje (avancim) në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën ka konkurruar.

Pas verifikimit të dokumentacionit të kandidatit Malazog Hoxha, NJBNJ ka konstatuar se i njëjti nuk i plotëson kërkesat e veçanta dhe nuk ka të drejtë të vazhdoj më tej konkurrimin, sepse ka të përfunduar studimet universitare Fakulteti ekonomik me 180 kredi, ndërsa për plotësimin e pozitës së lirë punuese kërkohet diplomë universiteti, Fakulteti i bujqësisë me 240 kredi, pra drejtimi dhe kreditë jo në përputhje me kushtet e veçanta të kërkuara në shpallje.

Nga sa u tha më sipër NJBNJ në bazë të nenit 45 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Kandidati i pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të parashtoj ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet me shkrim pranë NJBNJ në afat prej 7 ditëve nga data e njoftimit me këtë vendim përmes SIMBNJ.

### Vendimi të i dorëzohet:

Ankuesit  
Arkivit



Udhëheqës i NJBNJ

Besim Azizi